Lezhë, më 30.11.2023

# PROCESVERBAL

I mbajtur sot, në dt. 30.11.2023, në orën 12:00, në sallën e Bibliotekës "At' Gjergj Fishta" Lezhë, mbi mbledhjen e radhës për muajin Nëntor 2023 të këshillit të Bashkisë Lezhë.

Mbledhja u hap nga Kryetari z. Ndue Luli

- Ndue Luli: Duke parë që ka mungesë për marrjen e vendimeve me shumicë të cilësuar (25 vota), dy nga projekt vendimet mendojmë që t'i heqim nga rendi i ditës.

(lexon rendin e ditës)

Siç e thashë në fillim, pikat 4 dhe 5 janë ato që kërkojnë shumicë të cilësuar, mendojmë që t'i heqim nga rendi i ditës. Po u bë numri, jemi prapë këtu, mund t'i miratojmë, përndryshe të mos jenë në rendin e ditës.

Kush është dakord të miratojmë rendin e ditës, për momentin pikat 4 dhe 5 jo?

Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë me 23 vota PRO.

Vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës që është projekt vendim "Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6% për periudhën 01-31 Tetor 2023"

Përpara, çdo këshilltar ka një ndryshim i cili ka ardhë si rezultat i një lapsusi në llogaritje, në qytetin e Lezhës. Bëhet fjalë për gabim njerëzor në mbledhjen e një shume, që luan me

1300-1400 lekë të rritura, por në fund të fundit nuk është e saktë. Këtë projekt vendim te miratojmë me ndryshimin që keni përpara.
Kush është dakord?
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë, pra me 23 vota PRO.
Pika 2 - Projekt vendim "Për miratimin e ndihmës financiare për shtetasin LL.G. nga fondi i emergjencës".
Kush ka ndonjë mendim për këtë p/vendim?
- Pjetër Noka: Jemi dakord si komision.
- Noke Luli: Faleminderit z.Pjetër si kryetar i komisionit të Emergjencës
Kush është dakord me kalimin e p/vendimit?
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë, pra me 23 vota PRO.
Projekt vendimi tjetër është përsëri për Emergjencat "Për miratimin e ndihmës financiare për shtetasin A.D. nga fondi i emergjencës".
Kryetari i komisionit ka diçka në lidhje me të"?
Kush tjetër? S'ka.
Kush është dakord?
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë", pra me 23 vota PRO.
Lënguam pikat 4 dhe 5.
Vazhdojmë me pikën 6 - projekt vendim "Për një ndryshim në Vendimin e këshillit të Bashkisë

Lezhë nr. 8, datë 12.07.2023 "Për miratimin e komisioneve të përhershme të Këshillit të Bashkisë Lezhë dhe përbërjes së tyre.

Secili këshilltar e ka projektvendimin, i cili është miratuar në kryesinë e Këshillit, në mbledhjen që zhvilloi javën që shkoi. Kjo bëhet që komisionet e përhershme të Këshillit të jenë sa më funksionale. Ka kush ndonjë mendim në lidhje me të? S'ka. Kush është dakord?

Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezent, pra me 23 vota PRO.

Vijmë te pika 7 - projekt vendim "Për një ndryshim në Vendimin nr. 42, datë 28.09.2023 "Për zgjedhjen e anëtarëve të kryesisë dhe të kryetarëve të fshatrave si dhe miratimin e pagave për çdo fshat në Bashkinë Lezhë""

Dua të them që në gjithë bashkinë tonë ka pasur një pjesëmarrje vërtet për t'u falënderuar, jo vetëm të shumicës së anëtarëve të Këshillit, por edhe të njësive administrative, në mënyrë që ky proces të shkojë sa më mirë, por për arsye objektive dhe diku dhe subjektive, në disa fshatra nuk janë realizuar në datën përkatëse sipas vendimit të Këshillit, kështu që në lidhje me këtë, fjalën e ka z. Agostin për të dhënë sqarime.

- Agostin Marku: Faleminderit

Siç e tha dhe kryetari i Këshillit, kohas

prurës dhe impenjimit të anëtarëve të këshillit dhe të njësive administrative, por edhe vetë komunitetit në fshatra, në pjesën dërrmuese të fshatrave të Bashkisë Lezhë, i kanë zhvilluar këto zgjedhje, por kemi dhe diçka që për efekt mjeshtërore, për efekt të kushteve atmosferike, nuk janë zhvilluar. Ju këtë plvendim e keni, por ka nevojë për ca shtesa, pasi janë realizuar dhe përditësimet e fundit, të cilat kanë të bëjnë me njësinë administrative Blinisht, shtohet fshati Krajën që do të zhvillohet në 13 dhjetor 2023, për njësinë administrative Kolsh shtohet fshati Pataley që do bëhet në 15 dhjetor 2023, fshati Velë që do bëhet në 14 dhjetor 2023. Të tjerat janë siç janë parashikuar në projekt vendim. S'ka ndryshime të tjera. Faleminderit.

- Ndue Luli: Me ndryshimet e bëra, duke parë se është përditësuar këto pesë ditë që kur është bërë njoftimi, a jeni dakord që të miratohet ky plvendim?
Rezultati i votimit është:
20 vota PRO
1 ABSTENIM (këshilltarja Donika Hoxhia)
2 nuk morën pjesë në votim (këshilltarët Alfrida Marku, Emanuel Përjaku)

- Agostin Marku: Një sparim. Kjo është në kuadrin e transparencës. Ne kërkojmë që të bëhen zgjedhjet sepse kanë dështuar mbledhjet sipas grafikut që

keemi miratuar gjatë periudhës që lamë pas
dhe këto janë rreth 20 fshatra të cilët kanë
dështuar për zhvillimin e mbledhjeve për zgjedhjet
e kryetarëve të fshatrave. N.q.s ne sot nuk marrim
vendim, do të thotë që këshilli po i lë këto fshatra
pa u zgjedhë kryetarët. Mund të shkojë ndonjë
fshat që t'i emërojë kryetari, por si rregull duhet
t'i zgjedhim dhe monitorojmë ne si këshill.

- Alfrida Marku: Nuk i ke zgjedhë komuniteti por i keni zgjedhë si keni dashur vetë, kështu që vazhdoni e mbrojeni procedurën vetë, unë s'përfshihem.
- Agostin Marku: Kur nuk merr pjesë nëpër takime, mund të flasësh shumë lehtë nga zyrat. Pra ne duhet të shpejtojmë sepse n.q.s nuk marrim vendim sot, nuk mund të bëjmë zgjedhje. Prandaj kryetar, kërkoj edhe një herë miratimin e këtij p/vendimi.
- Ndue Luli: Atëherë, duhet të jemi secili koshient për detyrën që keemi. E para moskoshienca është te ato këshilltarë që mungojnë sot në mbledhjen e këshillit, ose më tepër ndonjë edhe pa arsye objektive ose subjektive qofshin ato. Unë, të gjithëve pa përjashtim, ju bëj kërkesë, që për të mirën e komunitetit të votojmë këtë p/vendim, i cili ka të bëjë me zgjedhjet e kryetarëve të fshatrave, të cilat do ngelin pezull, nuk dihet edhe për sa kohë, ku banorët në fshatra do ngelen pa shërbim në mungesë

të kryetarit të fshatit, n.q.s ne nuk e miratojmë që të bëhen zgjedhjet në afatin ligjor.
Prandaj, ju bëj kërkesë të gjithëve për përgjegjshtim, kush është dakord që p/vendimi me këto 2-3 ndryshimet e datave, të miratohet sot, në këtë mbledhje këshilli.
Rezultati i votimit është:
19 vota PRO
2 ABSTENIM (këshilltaret Donika Hoxhia dhe Donika Ndoj)
2 këshilltarë nuk morën pjesë në votim - Alfrida Marku dhe Emanuel Përjaku.
Atëherë, projekt vendimi nuk miratohet.
- Agostin Marku: Atëherë, ju njoftoj si këshill se nga ky moment, i lind e drejta Kryetarit të "Bashkisë" të bëjë emërimet në të gjitha fshatrat që nuk janë bërë zgjedhjet, me ligj. Faleminderit.
- Ndue Luli: Pika B është për njohje, informacion mbi realizimin e buxhetit për 10 mujorin 2023. Do kalojmë te pika "Të ndryshme".
Po zj. Marku.
- Alfrida Marku: Faleminderit. Të nderuar kolegë. Me qëllim transparencën me qytetarët si dhe me kolegët anëtarë të K.B., dua të bëj me dije se me shkresë zyrtare i jam drejtuar kryesisë së këshillit për të përfshirë në rend dite interpelancën me kryetarin e Bashkisë në lidhje me dy çështje, të cilat me të

drejtë kanë shkaktuar debat, diskutime dhe reagime publike. Është çështja e marrëveshjes për emigrantët si dhe vijimi i procesit të rindërtimit – Lënia pezull, pa zgjidhje e 53 familjeve në Lezhë. Këto dy kërkesa, për arsye që dihen tashmë, nga kryesia e këshillit janë refuzuar që të përfshihen në rendin e ditës. Kuptohet dhe nga mungesa e Kryetarit të Bashkisë sot, megjithatë, meqë këtu janë përfaqësues të bashkisë, unë do mundohem, në emër të gjithë qytetarëve, të ezauroj disa pyetje të cilat i kisha planifikuar për t'ia adresuar kryetarit të Bashkisë. I nderuar zv/kryetar i Bashkisë, me aq sa keni dijeni ju, që duhet të keni dijeni në fakt, a është vënë në dijeni Bashkia Lezhë paraprakisht për këtë marrëveshje, për sa kohë Porti i Shëngjinit dhe Gjadri janë pjesë e njësive administrative të Shëngjinit dhe Dajçit, në juridiksionin e Bashkisë Lezhë. Nëse po, pse kryetari i Bashkisë nuk ka kërkuar zhvillimin e një konsultimi paraprak me qytetarë e ekspertë. Në vijim, cili është qëndrimi juaj si institucion. A është ky qëndrim që ka mbajtur kryetari i Bashkisë publikisht, pas publikimit të kësaj marrëveshjeje, një qëndrim personal apo i konsultuar prej tij, duke parë reagimin e qytetarëve si dhe duke shtuar faktin se kjo marrëveshje, nëse zbatohet, do të sjellë pasojë në efatgjatë në jetën sociale dhe ekonomike, në rendin dhe sigurinë në Lezhë. A ka kërkuar Bashkia

e Lezhës llogari dhe informacion të detajuar, pse nuk ka marrë iniciativën për t'u konsultuar me qytetarët. Pas reagimeve diskriminuese dhe joetike tuajat, të kryetarit të Bashkisë dhe të stafit të bashkisë, i keni shpërndarë në rrjet atë statuse aspak etike për funksionin që përfaqësoni, a do kërkoni falje publike, duke filluar nga kjo mbledhje këshilli? Gjithashtu të gjithë anëtarët e K.B. Lezhë që të shfrytëzojnë këtë mbledhje dhe të shprehin pendimin e tyre në lidhje me marrëveshjen për emigrantët, e cila, siç e kemi cilësuar, është e paligjshme dhe e padrejtë. Bie në kundërshtim me Kushtetutën e Shqipërisë, me Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut, me Konventën për Refugjatët, krijon të gjitha kushtet e mundshme për të shkelur të drejtat e atyre emigrantëve, për të shkelur rendin dhe sigurinë. Sa i përket pikës 2 - procesit të rindërtimit. Dua t'u kujtoj përfaqësuesve të bashkisë se në momentet që flasim 12 familje të pallatit 47 në qendër të qytetit dhe 51 familje në njësitë administrative të tjera, banesa individuale, ende nuk kanë gjetur zgjidhje për rindërtimin e shtëpive të tyre të dëmtuara nga tërmeti, dhe për të cilat K.B. Lezhë ka marrë vendim për rindërtimin që në vitin 2021. Në emër të 53 familjeve kërkoj nga përfaqësuesit e Bashkisë Lezhë informacion pse është zvarritur ky proces, dhe a ka një datë të

afërt të cilën duhet t'ua komunikoni qytetarëve?
Faleminderit.

- Ermal Pacaj: Se i përket interpelancës, unë nuk isha përgatitur sepse këshilli nuk na ka sjellë diçka, pra nuk është se jam i autorizuar për të kthyer përgjigje kap në detyrë.
- Ndue Luli: Më fal z. nënkryetar. Të sqaroj, Kryesia e Këshillit e ka parë të arsyeshme që mos t'i fusë në rendin e ditës.
- Ermal Pacaj: Edhe unë po vetëm vetëm një 2 fjalë të thjeshta sepse në fakt është informacion që e kam. Se i përket pjesës së marrëveshjes, nuk është e nevojshme t'jua them unë, siç i dinë këshilltarët kompetencat e veta e të bashkisë, edhe bashkia i di kompetencat e veta. Historia e marrëveshjes nuk e ka fare bashkinë aktor. Atëherë, se Ermali jep një opinion personal, është shumë i lirë për të dhënë opinionin personal. Po, edhe Porti i Shëngjinit edhe Gjadri janë pjesë territoriale e Bashkisë së Lezhës por njëra ka pronar Ministrinë e Financave, tjetra Ministrinë e Mbrojtjes. Është kompetencë tërësisht e qeverisë shqiptare. Nuk është se kryetarit të Bashkisë Lezhë i është kërkuar për të dhënë një mendim. Është turturë në gotë që bëhet për populizëm, për të marrë vëmendje, pra në fund të ditës kryetari i Bashkisë është përfaqësues i të gjithë qytetarëve, kurse se i përket

pjesës së mendimeve, i kemi parë se protesta janë bërë. Është muhabet që nuk ia vlen t'ju hamë minuta juve me thënë të drejtën, kështu që dhe unë nuk po zgjatem më.
Sa i përket pjesës tjetër, që është shumë sensibël, rindërtimi, pare se të shkojmë te 53 familjet, duhet të shkojmë te 86 familjet në "Gurra", 95 familjet në lagjen "Besëlidhja", familjet në njësitë administrative, familjet me donatorët, që i kanë marrë çelësat në dorë dhe jetojnë në shtëpitë e reja, që si proces është thuajse 95 % i përfundimtar në Bashkinë e Lezhës.
Në lidhje me 53 familjet që këshilltarja Markaj kërkon informacion - ka dy problematika të ndryshme, njëra e pallatit të BKT-së siç i thamë ne dhe 40 familje që kanë kërkuar për t'iu ndërtuar shtëpitë shteti. Ne e kemi deleguar si problematikë, presim të marrim zgjidhje, se fondi është i alokuar. Problemi është se sipas Aktit Normativ 5 dhe 9, qeverisë shqiptare, shtëpitë të cilat do të rindërtohen, individuale, do bëheshin sipas projektit tip të Entit të Banesave të bashkive me projekt, bashkia vetëm preventiv, pra Bashkia Lezhë i ka nxjerrë procedurat. Procedura nuk ka interes sepse çmimet janë rritur, Ne kemi kërkuar që të paktën pjesa e preventivit sipas manualit të shtetit të ribëhet, pastaj Bashkia Lezhë të marrë përsipër shpenzimet

shtesë që kanë për t'u bërë ato shtëpi. Një problem tjetër që ka qenë, psh një banor në Rrilë do të blejë shtëpinë në apartament, ligji nuk ia lejon, pra duhet sesbën të bëjë shtëpinë aty ku e ka pasë. Janë e 40 e ca familje të tjera që i kanë marrë lekët për të bërë shtëpinë vetë, por nuk do të bëjë shtëpinë në atë vend. Pra, janë një sërë problemesh që do marrin zgjidhje me ndryshimin e bazës ligjore, të cilat besoj se brenda këtij viti do të ndryshohen. Sa i përket pallatit të BKT-së, ne kemi pasë një marrëveshje me shoqatën bamirëse "FIRDEUS" Elvis Naçi, i cili më pas u tërhoq për mungesë të fondeve dhe ne kemi kërkuar në qeveri dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit që të ndërtojmë. Është një pallat me diku të 3000 $m^2$ që dhe aty presim të marrim zgjidhje që të ndërtojmë me tipologjinë siç ka qenë i ndërtuar më përpara, për shkollë dhe të problematikave që ka me pronësitë, me katet e para të banimit, sepse procesi i rindërtimit nuk rindërton dyqane apo njësi shërbimi por vetëm shtëpi banimi ose apartamente. Ne kemi ndenjur në kontakt me të gjitha familjet dhe secila e ka marrë përgjigjen. Ato akoma trajtohen me bonusin e qerasë, deri në ditën që të marrin çelset, besoj dhe shpresoj që brenda 6-mujorit të parë të vitit 2024, procesit

të rindërtimit në Lezhë t'i vihet kapak.
Për këto të dyja key përgjigje kishe.

- Ndue Luli: Faleminderit.
Po, zj. Hoxhia.

- Donika Hoxhia: Përshëndetje. Unë do i rikthehem çështjes shumë të ndjeshme të emigrantëve.
Më duket jo etike të thuhet, "thjesht për të marrë vëmendje" dhe unë mendoj që fakti kur një njeri i vetëm protestonm, duhet marrë parasysh. Përpjekja për të dhënë si racizëm, edhe kjo për mua është shumë e ulët. Duhet të jemi pak më të sinqertë, pavarësisht partisë ku aderojmë, asaj që na thuhet, ne duhet të flasim si qytetarë lezhjanë dhe shumë prej nesh e shohim këtë si problem.
E pamë që nuk dinte gjë askush, kur doli marrë-veshja, se nuk dinte gjë askush, megjithatë, çdo gjë që flasim dhe shkruajmë mbrapa duhet të jetë nën përgjegjësi. Si individë mund të flasim dhe mund të peshim. Kemi peshur dhe me memet e shumta që jemi bërë. Unë sot jam edhe përfaqësuese e votuar nga qytetarët lezhjanë dhe më duket të jem pak më e kujdesshme në faqen time publike kur shpreh një opinion për një çështje të tillë. Unë ju thaj të gjithëve të shikoni më me seriozitet dhe mos të jemi thjesht të bindur pas një direktive që na vjen nga lart.
Lezha a do kthehet në një vend pritës të emigrantëve?
Ne i pritëm dhe të tjerët përpara. Nuk patëm shumë

ankesa, por në fakti n e përsëritur, kur të gjithë Shqipërinë është tjerrë përsëri votim Lezhe, z. nënkryetar i bashkisë, mendoj që duhet ta shikoni pak këtë problem sepse përvoja ka treguar që ka ndikuar shumë në qytetet ku ka ndodhur kjo gjë. Kam lexuar diku - mos u merakosni për turizmin. Po, po, do të merakosemi dhe për turizmin sepse e kemi jetën tonë këtu. Mjafton të hapim faqet italiane dhe të shohim çfarë ka ndodhur me Lampedusën. Është bërë edhe një libër në lidhje me këtë çështje.
(citon librin dhe përmbajtjen e tij).
(vazhdon të shprehë shqetësimin e saj në lidhje me këtë çështje dhe fton qytetarët që të reagojnë).
- Ndue Luli: Problem tjetër? Po z. Jaku
- Dod Jaku: Përshëndetje të gjithëve.
Kemi patur edhe drejtorin e OSHEE dhe u tha që Lejmani është i persekutuar por të gjithë jemi të persekutuar. Nuk shoh ndonjë përmirësim nga të gjitha problemet që u diskutuan atëherë.
E kuptoj që dhe kjo nuk është në kuadrin e bashkisë që të kërkojë ndonjë ose institucion, por po ta shohësh, ne si zonë e Bregut të Matës jemi zona më komode në aspektin gjeografik dhe jemi besoj, zona më problematike. Nuk e di z. Kryetar, a e kemi tagrin të bëjmë një relacion drejtorit të përgjithshëm të OSHEE për këtë problem?
Unë nuk e kuptoj se si nuk e respektojnë klientët,

nuk respektojnë kontratat
Problemi tjetër z. Ermal, duke pasur se ne si qytet parkimin, nuk e di nëse bashkia ka mundësi të bëjë një studim, sepse në qytet shohim vija të verdha, por a i vendosim me të drejtë apo të padrejtë, pagueshme apo jo, kjo mbetet që të shikojë sektori përkatës në bashki, që ai parking të funksionojë me orë, që thanë njerëzit të tjerë të kenë mundësinë për të parkuar.

- Ndue Luli: Faleminderit.

Fjalën e ke z. Ndreca

- Erin Ndreca: Sa për sqarim të opinionit publik. Në lidhje me interpelancat me Kryetarin e Bashkisë drejtuar Kryesisë së Këshillit, këtu u përgjigj sikur këshilli nuk është dakord. Jo. Në mbledhjen e kryesisë së këshillit janë argumentuar të gjitha pikat e rendit të ditës si dhe ato që nuk i përkasin këtij këshilli që të mos na zënë kohë nga mbledhja. Dhe mendoj që ka çështje më të rëndësishme për t'u diskutuar në funksion të të gjithë qytetarëve. Dhe përderisa znj. Afrida foli në emër të të gjithë qytetarëve, unë mendoj që nuk flet në emër të të gjithë qytetarëve, pasi dhe Ermali e shpjegoi që po të ishin të gjithë qytetarët, do ishin para bashkisë. Por ishin 2-3 veta që duan ~~te~~ shohin ashtu si e shohin ata. Sa i përket profesoreshës, i kuptoj shqetësimet tuaja, megjithatë situata nuk është as tragjike sa që po e bëni. Nëse qeveria shqiptare

ke vendosun që këta emigrantë të vijnë këtu, nuk është e njëjta gjë siç ndodh në Itali, që do të thotë që këta, nga Italia në Shqipëri, vijnë me rregulla dhe sipas informacioneve, do jenë të mbrojtur, të grupuar dhe të siguruar. Nuk besoj që është kaq e frikshme sa ç'doni ju ta paraqitni. Prandaj, ju lutem, t'i shohim gjërat me qetësi, mos të krijojmë panik.

- Ndue Luli: Fjalën e ke zj. Marku 2 minuta.

- Alfrida Marku: 1 minut, jo 2. Në vijim të asaj që foli kryetari i grupit të këshilltarëve të Partisë Socialiste. Ndjej keqardhje se si porta dhe hapur the që dy çështjet për të cilat kam kërkuar interpelancë, nuk përbëjnë çështje që përfaqësojnë interesin qytetar.

- Ndue Luli: zj. Hoxhia 2 minuta.

- Donika Hoxhia: Situata, po, nuk ka ndodhur akoma, po flasim që të mos ndodhë. A je i informuar se kush do vijë në Shqipëri? Ato që nuk do prekin brigjet e Lampedusës. Mos i krahaso zotëri me afganët, janë dy kultura krejtësisht të ndryshme.

- Ndue Luli: z. Troshaj e ke fjalën.

- Alfons Troshaj: Përshëndetje.
Të udhëtosh brenda qytetit të Lezhës është një problem shumë i madh nga trafiku e pasagjerëve që vijnë nga rrethet. Është bërë shqetësim shumë i madh sidomos te Ura e Lenit sepse aty parkojnë

në mënyrë të padiskutueshme dhe asnjë institucion nuk ndërhyn aty. Mendoj që t'u gjehet një vend jashtë qytetit. Po ashtu dhe furgonat e mollit, ndalojnë para marketeve me nga gjysmë ore. Të gjithë e njohim trafikun. E dyta, ujësjellësit e ri që janë ndërtuar në Nj. A. Zejmen. Unë e kam ndjekë dhe me specialistët e ministrisë që kanë ardhë dhe janë ndërhyrje skandaloze. Unë kam mendimin që të bëhemi një grup këshilltarësh e specialistë të bashkisë e t'i shikojmë problemet që kanë këto ujësjellësa dhe uji është shumë i pistë. Faleminderit.

- Ndue Luli: Fjalën e ka z. Tushaj.
- Pjetër Tushaj: Përshëndetje të gjithëve.

Unë pata vetëm një këshillë. Kjo shoqja këtu ka shumë të drejtë. Unë kam pasur familje afgane në hotel, me fëmijë, intelektualë. Kjo është shumë e dëmshme për ne. Të pohojmë të heshtim. (i referohet emigrantëve)

Pse përsëri në Lezhë? Nuk pati vend tjetër?

- Ndue Luli: Po znj. Ndoj.
- Donike Ndoj: Përshëndetje të gjithëve.

Në lidhje me emigrantët, shpresoj të bëhet më e mira për vendin tonë.

Një pyetje e kam direkt për z. nënkryetar.

Në lidhje me arsimin parashkollor, edukatorja më tha që 3 nxënës kishin dorëzuar letrat dhe kishin kërkuar që të kishin një mësues ndihmës, në kopshtin

Zejmen. Nuk e di ku ka çaluar puna. Jonë fëmijë me vështirësi në të nxënë.

- Ermal Pacaj: Në fakt nuk e kam informacionin. Duhet të shoh ku ka ngelë gjëja.
- Ndue Luli: Një sqarim: Kryesia e këshillit, e mbledhur javën e kaluar, i mori në shqyrtim mendimet e këshilltares për të cilat u fol këtu. Asnjë prej nesh këtu nuk do që të vijnë emigrantë këtu, e them me plot bindje. Jonë politika shtetërore, qeveritare, humanitare. Mos marrje në interpelancë për këtë çështje është se nuk e ka pyetur kush as kryetarin e bashkisë e as ne që jemi përfaqësuesit e popullit të Lezhës.
  Në lidhje me të dytën, me tërmetin, nuk ka mbledhje të këshillit Bashkiak, që nga tërmeti, që nuk është ngritur problemi i rindërtimit, madje dhe gjatë këtij 6-mujori disa herë, me të drejtë, siç është ngritur dhe sot dhe ne është dhënë përgjigje dhe asnjëjë kjo ka qenë, për mos t'u marrë direkt me interpelancën.
  Ju falenderoj për pjesëmarrjen dhe mirëkuptimin në mbledhjen e zhvilluar.
- Mbledhja u transmetua live në Facebook në faqen "Këshilli i Bashkisë Lezhë".

SEKRETARI
FLORIDA GJUNAJ

KRYETARI
NDUE LULI